

**KONTRATË**

Nr. \_\_\_\_\_

**Ndërmjet****Palëve kontraktuese**

1. **Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural** si palë që jep mbështetjen financiare (më poshtë referuar si: Agjencia-AZHBR) e përfaqësuar nga Drejtore e Përgjithshme \_\_\_\_\_, me adresën e selisë dhe korrespondencës: \_\_\_\_\_, Tiranë nga njëra anë, dhe
2. Emri i Përfituesi Z. \_\_\_\_\_ me numër NIPT: K \_\_\_\_\_ T, si palë që përfiton fondet (më poshtë referuar si: Përfituesi), përfaqësuar nga Administratori Z. \_\_\_\_\_ me numrin e kartës së identitetit \_\_\_\_\_, me adresë: Lagjia “ \_\_\_\_\_

Kanë rënë dakord për sa më poshtë:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Objekti i Kontratës**

(1) Kjo kontratë rregullon të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese lidhur me rregullat që rrjedhin nga Programi IPARD dhe rregullat për autorizimin e pagesave dhe përdorimit të tyre, të miratuara nga Agjencia me anë të Njoftimit nr. \_\_\_\_ të datës \_\_\_\_ nga thirrja publike nr. \_\_\_\_ e datës \_\_\_\_\_

(2) Kontrata e nënshkruar u referohet:

a) Masa: \_\_\_\_\_

b) Grupi i investimeve: \_\_\_\_\_

c) Lloji i investimit: \_\_\_\_\_

d) Shpenzimet e pranueshme: \_\_\_\_\_  
të cilat do të përdoren për mallrat/shërbimet/punimet e përcaktuara në Tabelën për mallrat dhe shërbimet e dhënë si Shtojca 1 e kësaj Kontrate.

(3) Vendndodhja e objektit të investimit të kontratës për të cilin është nënshkruar kontrata është:

- a) Adresa: \_\_\_\_\_ kod i postës \_\_\_\_\_
- b) Qyteti: \_\_\_\_\_
- c) Njësia Administrative (Fshati) \_\_\_\_\_
- d) Rajoni: \_\_\_\_\_
- e) Nr. i pasurisë: \_\_\_\_\_
- f) Zona kadastrale:

## Neni 2 Shuma e kontraktuar

(1) Totali i miratuar i shumës së investimit është x(x) LEKË.

(2) Totali i shpenzimeve të pranueshme të investimit është x(x) LEKË.

(3) Kontributi i përgjithshëm publik i aprovuar me Noftimin nr. \_\_\_\_\_ datë \_/\_/ është në shumën \_\_\_\_\_ ( Me fjalë \_\_\_\_\_ LEKË) që është \_\_\_\_\_ % e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

(3a) Kontributi i përgjithshëm publik përbëhet nga:

- Shuma \_\_\_\_\_ LEKË 75% e Kontributit të BE
- Shuma \_\_\_\_\_ LEKË, 25% e financimit kombëtar.

(4) Shuma e kontributit publik që përfaqëson bashkëfinancimin kombëtar është 25% e shumës së kontributit publik të përcaktuar në paragrafin (3a) pika 1 të këtij neni.

(5) Shuma e kontributit publik që përfaqëson pjesën e kontributit të BE është 75% e shumës së kontributit publik të përcaktuar në paragrafin (3a) pika 2 të këtij neni.

(6) Agjencia (AZHBR) paguan (50, 60,65) % nga shpenzimet e realizuara, të vërtetuara dhe të pranueshme, por jo më shumë se shuma e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni dhe jo më shumë se shuma për mallrat/shërbimet e investimit të përmendura në Shtojcën 1 të kësaj Kontrate  
- Tabela për mallrat dhe shërbimet, edhe nëse shpenzimet reale e tejkalojnë shumën e aprovuar.

(7) Përqindja e kontributit publik të përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni mund të ndryshohet vetëm në rast të ndryshimit të kontratës për shkak të fatkeqësive natyrore.

(8) Shuma e deklaruar sipas paragrafit 3 të këtij neni paguhet pas përfundimit të investimit dhe dorëzimit të kërkesës për pagesë të përcaktuar në nenin 4 paragrafi (1), (2) dhe (3) në numrin e mëposhtëm personal të llogarisë bankare të Përfituesit AL4X5, në bankën e mëposhtme BANK me Nr.SËIFT: .

## II. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

### Neni 3 Të Drejtat e Përfituesit

(1) Përfituesi ka të drejtë të marrë pagesën e fondeve deri në shumën e përcaktuar në nenin 2 paragrafi (3) të kësaj Kontrate dhe deri në shumën për mallrat/shërbimet e investimit të përmendur në Shtojcën 1 të kësaj Kontrate në përputhje me mënyrën, kushtet dhe afatet kohore të përcaktuara në këtë Kontratë.

- a. Përfituesi ka të drejtë që brenda tre muajsh nga firmosja e kontratës të kërkojë pagesë paraprake deri në 50 %, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 4/2 dhe nenin 6/2.
- b. Për investimet që përmbajnë punime ndërtimi/rindërtimi, përfituesi ka të drejtë të kërkojë pagesë pjesore për punimet e ndërtimit/rindërtimit vetëm pas finalizimit minimumi të 60% të investimit, në përputhje me kushtet e vendosura në neni 4/4 dhe neni 6/2.

(2) Përfituesi ka të drejtë të kërkojë ndryshime të kësaj Kontrate së paku 30 ditë pune para afatit të përfundimit të investimit të përmendur në nenin 4 paragrafi (3) ose të paktën 60 ditë para afatit të përfundimit të aktiviteteve të investimit të përmendur në Nenin 4, paragrafi (4) të kësaj Kontrate.

(3) Përfituesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e kësaj kontrate në këto raste:

- a) zgjatje e afatit të përfundimit të investimit (Neni 4, paragrafi 3);
- b) zgjatje e afatit të paraqitjes së kërkesës për pagesë (Neni 4, paragrafi 4);
- c) ndryshime në ndërtimin/rikonstruksionin e investimit, objekt i kësaj Kontrate (Shtojca 1);
- d) ndryshime në llojin/modelin e mallrave/shërbimeve të miratuara, objekt i kësaj Kontrate (Shtojca 1) pas paraqitjes së një njoftimi të përgjithshëm shpjegues të ndryshimeve në llojin/modelin e mallrave/shërbimeve të aprovuara;
- e) ndryshime në një pjesë të investimit, objekt i kësaj Kontrate;
- f) ndryshimi i furnitorit/ëve pas paraqitjes së një njoftimi të përgjithshëm shpjegues të ndryshimit të furnitorit;
- g) ndryshimi i Përfituesit në rast të vdekjes së Përfituesit (personit fizik)
- h) ndryshimi i të dhënave personale (adresa, transaksioni/llogaria bankare, ndryshimi i të dhënave personale të kartës së identitetit, etj).

(4) Përfituesi ka të drejtë të kërkojë ndryshime të kësaj Kontrate në lidhje me dispozitën e përmendur në paragrafin (3), të këtij Neni vetëm në rast të:

- një force madhore,
- fatkeqësive natyrore të njohura nga Autoriteti Shtetëror,
- ndalimit/ndërprerjes së prodhimit të mallrave të caktuara të cilat janë pjesë e investimit, objekt i kësaj Kontrate,
- pamundësisë së furnitorëve për të ofruar mallra ose shërbime,
- ndryshimeve që lindin nga nevoja për sinkronizim me legjislacionin,
- situatave që nuk mund të parashikohen në momentin e kontraktimit,
- futjes së teknologjive të reja që mund të përmirësojnë efikasitetin e investimit, objekt i kësaj Kontrate.

(5) Përfituesi ose personi i autorizuar prej tij/saj ka të drejtë të deklarojë vërejtjet e tij/saj për kontrollin e kryer në vend në raportin për kontrollin në vend dhe të nënshkruajë atë.

#### **Neni 4** **Detyrimet e Përfituesit**

- 1) Përfituesi është i detyruar të para financoje vetë (me aktive të likuidueshme/vetëm me para) totalin e shumës së investimit përmendur në Shtojcën 1 të kësaj nga ai vetë/ajo vetë.
- 2) Pagesa paraprake e përfituesit cilësohet nga autoriteti kontraktues si shpenzim i pranueshëm deri në 50% të ndihmës publike lidhur me projektin, dhe duhet ti nënshtrohet vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të ( me vlefshmëri deri në 6- muaj nga data e përfundimit të investimit të përcaktuar në kontratën e grantit), që do ti korrespondojë 110 % të shumës parapaguar.

Parapagesat deri në 20% të ndihmës publike në lidhje me projektin

- por (që nuk tejkalojnë) ekuivalentin prej 100,000 Euro,

do të jenë subjekt i vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të;

- Parapagesat nga 20% deri në 50% të ndihmës publike në lidhje me projektin dhe / ose që tejkalojnë ekuivalentin e 100,000 Euro,

do të jenë subjekt i vendosjes vetëm të garancise bankare.

- 3) Pagesa paraprake përbëhet maksimalisht nga:

- Shuma \_\_\_\_\_ LEKË 75% e Kontributit të BE

- Shuma \_\_\_\_\_ LEKË, 25% e financimit kombëtar.

- 4) Pjesa pjesore e përfituesit cilësohet nga autoriteti kontraktues si shpenzim i pranueshëm deri në 60% të ndihmës publike lidhur me projektin që përmban punime ndërtimi/rindërtimi, dhe duhet ti nënshtrohet vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të ( me vlefshmëri deri në 6- muaj nga data e përfundimit të investimit të përcaktuar në kontratën e grantit). Në këtë vlerë llogaritet dhe shuma që përfituesi merr në bazë të nenit 4/2.
- 5) Përfituesi është i detyruar të përfundojë investimin e përmendur në Nenin 1 të kësaj Kontrate jo më vonë se \_\_\_\_\_. Në rast se autoritetet teknike nxjerrin një raport me një afat për përmbushjen e standarditeve në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë në punë, investimi nuk do të konsiderohet i përfunduar.
- 6) Përfituesi është i detyruar t'i dërgojë AZHBR raportin e progresit (Shtojca 4) për të gjitha investimet e ndërtimit/rikonstruksionit bazuar në planet/projektet inxhinierike/arkitekturore. ku aktivitetet përfshijnë punime fshehura. AZHBR duhet të jetë në dijeni 5 ditë pune përpara se punimi i fshehtë të fillojë të realizohet.
- 7) Përfituesi është i detyruar që në afatin prej 30 ditësh kalendarike pas investimit përmendur në paragrafin (3), të paraqesë kërkesën për pagesë dhe të gjitha dokumentet e kërkuara me kërkesë, jo më vonë se \_\_\_\_\_
- 8) Përfituesi është i detyruar të paraqesë formularin e fundit të aprovuar të kërkesës për pagesë me postë rekomande ose personalisht sipas nenit 8, paragrafi (3).
- 9) Përfituesi është i detyruar të shlyejë të gjitha pagesat ndaj palëve të treta që rrjedhin nga zbatimi i investimit sipas afateve kohore të përmendura në paragrafin (3) të këtij neni.
- 10) Përfituesi është i detyruar të përmbushë *standardet kombëtare/të BE* në fushën e \_\_\_\_\_, në fund të realizimit të investimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Programin IPARD dhe paragrafin (3) të këtij neni. Përmbushja e Standardeve Kombëtare/të BE konsiderohet e pranueshme kur Autoritetet Teknike përkatëse në fushën e \_\_\_\_\_ lëshojnë certifikatën. Në rast se autoriteti teknik nxjerr një raport me një afat për përmbushjen e standardit kombëtar/të BE, investimi nuk do të konsiderohet i përfunduar, sipas Programit IPARD, paragrafi \_\_\_\_\_
- 11) Përfituesi është i detyruar të mbështesë kërkesën për ndryshim të kontratës me dokumentet e duhura që garantojnë plotësimin e kushteve të përmendura në nenin 3 paragrafi (3) dhe (4) në përputhje me nenin 8 paragrafi (3).
- 12) Përfituesi është i detyruar të dërgojë informacion/të dhëna me kërkesë të AZHBR.
- 13) Përfituesi është i detyruar të informojë menjëherë AZHBR për shfaqjen e rrethanave që ndikojnë ndjeshëm në ekzekutimin e kësaj Kontrate.
- 14) Përfituesi është i detyruar të ofrojë akses të plotë në dokumentacionin, ndërtesat, ambientet, pajisjet dhe pronën që kanë të bëjnë me investimet për personat e autorizuar të Agjencisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Komisionit Evropian, Gjykatës së Audituesve, si dhe Autoritetit të Auditimit gjatë kryerjes së kontrollit

në vend dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kësaj Kontrate në çdo kohë gjatë vlefshmërisë së kësaj Kontrate.

- 15) Përfituesi në rast ndërtimi ose rindërtimi është i detyruar të mbajë dosjen teknike të punimeve në përputhje me ligjin kombëtar për ndërtimin ose rindërtimin, (Sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011, "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe testimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98 datë 25.07.2011, Udhëzimit Nr.2, datë 13.5 .2005 "Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit").
- 16) Përfituesi ose përfaqësuesit e tij/saj i autorizuar janë të detyruar të identifikohen me kërkesë të personave të autorizuar të AZHBR gjatë kryerjes së kontrollit në vend.
- 17) Përfituesi është i detyruar të mos tjetërsojë, marrë me qira ose japë objektin e investimit të kësaj kontrate për sa kohë që ajo është në fuqi.
- 18) Përfituesi është i detyruar të mos ndryshojë qëllimin e objektit të investimit të kësaj kontrate për aq kohë sa ajo është në fuqi.
- 19) Përfituesi është i detyruar të mos ndryshojë vendndodhjen e objektit të investimit të kësaj kontrate.
- 20) Përfituesi është i detyruar të mbajë dokumentacionin origjinal që lidhet me objektin e kësaj Kontrate për aq kohë sa kjo Kontratë është në fuqi.
- 21) Përfituesi është i detyruar të kryejë veprimet e kontabilitetit/mbajtjen e llogarive/të dhënat e kontabilitetit sipas kërkesave të legjislacionit kombëtar dhe për nevojat e shërbimeve të Agjencisë dhe Ministrisë për aq kohë sa kjo Kontratë është në fuqi.
- 22) Përfituesi është i detyruar të mos përdorë fonde të tjera të BE ose donatorëve të huaj ose fonde të brendshme për financimin e të njëjtit investim në formën e granteve.
- 23) Përfituesi është i detyruar të shlyejë taksën e pronës, detyrimet tatimore, kontributet shëndetësore, sigurimet e pensionit dhe paaftësisë për punë si dhe detyrimet e kërkuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën që kjo Kontratë është në fuqi.
- 24) Përpara paraqitjes së kërkesës për pagesë, Përfituesi është i detyruar të shlyejë borxhet, nëse ka, që rrjedhin nga përdorimi i fondeve nga fushat e tjera të IPA-s ndaj Ministria e Financave/Fondi Kombëtar/CFCU.
- 25) Përfituesi është i detyruar të kthejë menjëherë tepricën në rastet kur është paguar më shumë se ç'duhej, përndryshe AZHBR do të llogarisë interesin e vonuar mbi të.
- 26) Përfituesi është i detyruar të vendosë një tabelë (billboard të përkohshëm) me madhësi të konsiderueshme, në një vend lehtësisht të dukshëm për publikun, për çdo punim i cili ka lidhje me financimin e infrastrukturës ose punimet ndërtimore
  - a. Kjo tabelë (billboard) duhet të përmbajë emërtimin dhe objektivin kryesor të punimeve / projektit dhe të nxjerrë në pah mbështetjen financiare të siguar nga Bashkimi Europian, sipas shumës të kontratës nënshkruar ndërmjet Agjencisë IPARD dhe përfituesit. Prandaj duhet plotësimi edhe me mbështetjen financiare publike dhe kontributin financiar privat, në mënyrë që kostot totale të projektit të jenë transparente.
  - b) Përfituesi duhet të informojë publikun për projektin dhe financimin IPARD në vendin e investimit, gjatë zbatimit të projektit si më poshtë :

- Tabela me madhësi minimale A3 me informacion për projektin që përfshin mbështetjen financiare të Bashkimi European dhe është lehtësisht i dukshëm për publikun, siç është zona e hyrjes së ndërtesës, (për projekte me mbështetje publike <20.000 EUR)
- Tabela informuese me madhësi minimale A3 e cila informon lidhur me projektin, përfshin mbështetjen financiare nga Bashkimi European, duhet të jetë lehtësisht e dukshme për publikun, siç është zona e hyrjes së ndërtesës. Tabela informuese duhet të jetë prej materiali më të qëndrueshëm sesa tabela për projektet e vogla.

27) Për projektet e vogla (<20.000 euro) dhe te mesem (>20.000 euro) keto kërkesa përfundojnë në momentin e pagesës përfundimtare nga Agjencia IPARD. Për projektet e mëdha (> 100.000 EUR) kërkohet tabelë e përherëshme me një madhësi minimale A3 e vendosur në vend lehtësisht të dukshëm për publikun, siç është zona e hyrjes së ndërtesës, pasi projekti të ketë përfunduar, brenda 3 muajve pas përfundimit të punimeve. Tabela informuese duhet të jetë bërë nga material i qëndrueshëm, që zgjat të paktën gjatë një periudhe ex-post 5 vjeçare. Kërkesat për tabelën e përhershme janë:

- Duhet të ketë fjalitë e mëposhtme:

'Ky [lloj projekti] u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit European dhe - duhet të ketë stemën e BE-së

28) Gjatë 5 viteve ex post , pajisjet / asete e periudhës të bashkëfinancimit nga IPARD (e të gjitha kategorive të projekteve), duhet të shënohen qartë me 'shënues' (stickers) që tregojnë se ato janë të bashkë-financuara nga asistenca IPARD / BE.

29) Tabelat, posterat, pllakatat dhe faqet e internetit (shpjeguese), duhet të përmbajnë një përshkrim të projektit / veprimtarisë duke treguar që projekti është mbështetur nga IPARD dhe duke përfshirë emblemën e Unionit. Ky informacion duhet të marrë të paktën 25% të tabelave, pllakatave ose faqeve në internet. Aty ku duhet të përdoret emblema e Bashkimit Evropian, është e detyrueshme të shtohet një referencë e qartë për IPARD si më poshtë:



30) Nëse aplikanti, pavarësisht nga kërkesa e AZHBR-së deri në tre herë, nuk përmbush detyrimet e parashikuara në paragrafin 23 dhe vazhdimësinë e këtij neni, mund të çojë në përfundimin e kontratës.

31) Përfituesi duhet të dorëzojë pranë AZHBR Grafikun e Punimeve (shtojca 5), për ndërtimet/rindërtimet në investim, ku të parashikohet kohëzgjatja e punimit për secilën fazë të ndërtimit/rindërtimit.

32) Përfituesi duhet të informoj AZHBR, për çdo ndryshim që mund të bëjë në investim

- 33) Përfituesi është i detyruar të mos bëjë ndryshime në investim, të cilat ndikojnë në përmbushjen e kriterëve përkatëse të përzgjedhjes sipas aneksit 6 të kontratës.
- 34) Nëse kriteret e përzgjedhjes nuk përmbushen në fund të investimit sipas nenit 4/3, kërkesa për pagesë do të refuzohet dhe kontrata do të përfundojë.
- 35) Në rast kur kontrata përfundon për shkak të pavlefshmërisë së garancisë sipas nenit 5/15, përfituesi duhet të kthejë pagesën paraprake tek autoriteti kontraktues, në të kundërt do të përfshihet në listën e debitorëve.

## **Neni 5**

### **Të Drejtat e AZHBR**

- 1) AZHBR ka të drejtë të kryejë kontroll në vend në çdo kohë dhe në fazën e zbatimit të investimit dhe për aq kohë sa kjo kontratë është në fuqi.
- 2) AZHBR ka të drejtë të kërkojë dokumentacion plotësues/shtesë që nevojitet për sqarimin e kërkesës për pagesë, pra, dokumentet e nevojshme brenda një afati kohor të përcaktuar.
- 3) AZHBR ka të drejtë të marrë raportin e progresit (Shtojca 4) për të gjitha investimet e ndërtimit/rikonstruksionit bazuar në planet/projektet inxhinierike/arkitekurore ku aktivitetet përfshijnë punime të fshehura.
- 4) AZHBR ka të drejtë të kërkojë informacion, të dhëna dhe materiale të nevojshme për monitorimin, vlerësimin e investimeve dhe kryerjen e kontrollit në vend si dhe akses në të gjitha objektet, ambientet, pajisjet dhe pronat që lidhen me objektin e investimit të kësaj Kontrate.
- 5) AZHBR ka të drejtë të iniciojë ndryshimin e Kontratës së Grantit në rastet kur janë zbuluar mangësi ose gabime në aplikimin e shqyrtuar pas nënshkrimit të Kontratës së Grantit (gabime teknike, gabime në përlllogaritjet)
- 6) Neni 5/5 nuk aplikohet dhe AZHBR vijon me korrigjimin e gabimit në llogaritje në raste se vlera nga gabimi në llogaritje zë 2% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por në çdo rast jo më shumë se 50.000 lek. Në çdo rast AZHBR njofton përfituesin për ndryshimet e bëra.
- 7) AZHBR ka të drejtën të mos marrë parasysh kërkesën për pagesë nëse Përfituesi nuk paraqet kërkesën për pagesë në përputhje me Nenin 4, paragrafi (5).
- 8) AZHBR ka të drejtë të refuzojë autorizimin e kërkesës për pagesë tërësisht ose të korrigjojë shumën e pagesës përfundimtare pjesërisht nëse Përfituesi:
  - a) nuk plotëson apo sqaron kërkesën, pra, me dokumentet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar,
  - b) nuk e përfundon objektin e investimit të kësaj Kontrate në përputhje me Nenin 4, paragrafët (3) dhe (6),
  - c) fsheh faktet dhe informacionin për realizimet e objektit të investimit të kësaj kontrate.
  - d) nuk realizon investimin në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë.



- e) për shkak të diferencave të kursit të këmbimit nga kontraktimi deri në pagesën përfundimtare.
  - f) nuk arrin të përmbushë kriteret përkatëse të përzgjedhjes sipas Aneksit 6 të kontratës.
- 9) AZHBR ka të drejtën të mos lejojë përdorimin e fondeve në kuadër të Programit IPARD 2014-2020 për një periudhë 2 vjeçare nëse Përfituesi ka marrë mbështetje financiare nga AZHBR si rezultat i një aktiviteti mashtrues.
- 10) AZHBR ka të drejtë të njoftojë në faqen e internetit informacionin e mëposhtëm mbi Përfituesit:
- Emri dhe mbiemri (*kur Përfituesi është person fizik*) ose emrin e plotë ligjor të regjistruar (*kur Përfituesi është person juridik*),
  - Bashkinë dhe qarkun ku banon apo është i regjistruar Përfituesi, kodin postar.
  - Shumën e fondeve në lekë të paguara sipas programit IPARD 2014-2020.
- 11) AZHBR ka të drejtë të refuzojë kërkesën për ndryshime të kësaj Kontrate të paraqitur nga Përfituesi nëse këto ndryshime ndikojnë në:
- a) përmbushjen e standardeve kombëtare;
  - b) përmbushjen e standardeve të BE;
  - c) qëndrueshmërinë e investimit;
  - d) funksionalitetin e njësisë sipas strukturës operationale dhe procesit teknologjik të të gjithë investimit dhe nuk ndikojnë në linjën e prodhimit (në rast se ndryshimi i kërkuar prek një pjesë të investimit);
  - e) periudhën maksimale për realizimin e investimit pas nënshkrimit të kontratës;
  - f) legjislacionin kombëtar në fuqi.
  - g) Kriteret e përzgjedhjes sipas parashikimeve të sanksionuar në nenin 4/31
- 12) AZHBR ka të drejtë të kërkojë kthimin e fondeve nëse Përfituesi:
- a) ka dorëzuar dokumente të falsifikuara dhe i ka paraqitur si bazë për marrjen e fondeve nga Programi IPARD 2014-2020, ka përdorur/përdor fonde të tjera të BE-së ose fonde të tjera vendase ose të huaja me qëllim financimin e të njëjtit investim në formën e granteve,
  - b) ka tjetërsuar, dhënë ose marrë me qira, ose ka ndryshuar qëllimin e objektit të investimit të kësaj Kontrate,
  - c) ka ndryshuar vendndodhjen e objektit të investimit të kësaj Kontrate,
  - d) në rast se është paguar më shumë se ç' duhej për shkak të gabimit administrativ të AZHBR,
  - e) nuk ka siguruar akses të plotë në dokumentacionin, ndërtesat, ambientet, pajisjet dhe pronën që kanë të bëjnë me investimin për personat e autorizuar të AZHBR, Ministrisë së Financave, Komisionit Evropian, Gjykatës së Audituesve si dhe Autoritetit të Auditimit gjatë kryerjes së kontrollit në vend dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kësaj Kontrate në çdo kohë gjatë vlefshmërisë së kësaj Kontrate;

- f) nuk ka vendosur pllakatën përkujtimore/afishen dhe/ose tabelën që tregon se investimi financohet nga Programi IPARD 2014-2020 brenda 5 ditëve nga ekzekutimi i pagesës dhe për aq kohë sa kjo Kontratë është në fuqi dhe
  - g) në situata të tjera të përcaktuara nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.
- 13) AZHBR ka të drejtë, në rast të kthimin të fondeve të përcaktuara në paragrafin (12), të këtij neni të përlllogarisë një interes duke filluar nga dita pas skadimit të afatit të përcaktuar në njoftimin për kthimin e fondeve të nxjerrë nga AZHBR. AZHBR llogarit interesin në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 42, paragrafi 1 pika (c) të Marrëveshjes Sektoriale.
- 14) AZHBR ka të drejtë të nis procedurat ligjore në rast se përfituesi nuk ka kthyer shumën e marrë nga fondi brenda 15 ditëve pas marrjes së njoftimit për kthimin e shumës.
- 15) AZHBR ka të drejtë të kontrolloj vlefshmërinë e garancisë dorëzuar sipas nenit 4/1, duke i nisur një kërkesë institucionit që e lëshon garancinë. Procesi do të rregullohet bazuar në marrëveshje të shkruar ndërmjet institucioneve.
- 16) Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës personi fizik apo juridik që ka lëshuar garancinë:
- i. Nuk është i aftë/ nuk dëshiron të përmbush detyrimet e tij;
  - ii. Nuk është i autorizuar të lëshoj garancinë tek autoriteti kontraktues;
  - iii. Rezulton të jetë jo i besueshëm financiarisht ose garancia financiare bëhet e pavlefshme dhe përfituesi nuk arrin ta zëvendësoj

Autoriteti kontraktues mund të bëjë një zbritje të barabartë me shumën e pagesës paraparke ne pagesën e ardhshme ose i kërkon përfituesit e shkresë që të sigurojë një garanci të re me të njëjtat kushte si e para.

Në rast se përfituesi nuk arrin të sigurojë një garanci të re, autoriteti kontraktues ka të drejtë të ndërpresë kontratën.

## **Neni 6**

### **Detyrimet e AZHBR**

- 1) AZHBR është e detyruar të ekzekutojë pagesën brenda gjashtë muajve nga paraqitja e kërkesës së plotë për pagesë.
- 2) AZHBR mund të kryejë pagesën në dy ose më shumë\* këste:
  - a. Kësti i parë mund të jetë deri në shumën prej 50% të mbështetjes publike lidhur me projektin
  - b. Pagesa pjesore, minimumi 60% sipas neni 4/4 në momentin e finalizimit të punimeve të ndërtimit/rindërtimit.
  - c. Kësti final duhet të paguhet në fund të investimit, në mënyrë që të mund të verifikohet shpërndarja e produkteve, shërbimeve të bashkë financuara, si dhe vërtetësinë e shpenzimeve të kërkuara.

*\* Vetëm në rast se një parapagesë është disbursuar, pagesa pjesore konsiderohet si këst i dytë me së paku 60% të shpenzimeve publike.*

- 3) AZHBR është e detyruar të kryejë kontroll në vend nga personat e autorizuar të cilët janë të detyruar të identifikohen para Përfituesit ose përfaqësuesit e tij/saj të autorizuar.
- 4) AZHBR është e detyruar, pas pranimit të kërkesës për ndryshim për shkak katastrofe natyrore, të veprojë në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Sektoriale.
- 5) AZHBR është e detyruar të veprojë sipas të dhënave personale të Përfituesit në përputhje me legjislacionin nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale.

### **III. NDËRPRERJA E KONTRATËS**

#### **Neni 7**

(1) Kjo kontratë ndërpritet:

- me marrëveshje reciproke ndërmjet palëve kontraktuese,
- në mënyrë të njëanshme nga AZHBR, kur Përfituesi nuk zbaton dispozitat e kësaj Kontrate,
- në mënyrë të njëanshme nga Përfituesi vetëm para se të bëhet pagesa e fondeve.

(2) Në rast të ndërprerjes së kontratës nga paragrafi (1), pika 2 e këtij neni, AZHBR do të njoftojë menjëherë Përfituesin.

(3) Në rast të ndërprerjes së kontratës nga paragrafi (1) pika 3 e këtij neni, Përfituesi është i detyruar të njoftojë AZHBR së paku 15 ditë përpara afatit të përmendur në nenin 4 paragrafi (3) të kësaj kontrate.

### **IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 8**

##### **Shkëmbimi i informacionit**

(1) Përfituesi deklaron nën përgjegjësinë e plotë morale, materiale dhe penale që të gjitha të dhënat nga raportet, dokumentet dhe deklaratat e dorëzuara në Agjenci (AZHBR) janë të besueshme dhe autentike.

(2) Përfituesi deklaron se nuk ka filluar me realizimin e objektit të investimit të kësaj kontrate para hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate.

(3) Për informacion mbi dokumentet e duhura që duhet të dorëzohen me kërkesën për ndryshim të kësaj kontrate dhe për marrjen e versionit të fundit të aprovuar të kërkesës për pagesë, si dhe për dorëzimin e tyre pranë Agjencisë (AZHBR), Përfituesi duhet të kontaktojë me Agjencinë (AZHBR), si më poshtë

Adresa: Rr.”Muhamet Gjollesha”, Nr.56, Tiranë.

Nr. Telefoni: +355 422 28318

ose faqja: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al)

### **Neni 9**

#### **Mosmarrëveshjet**

Në rast mosmarrëveshjesh ose keqkuptimi që mund të rezultojë nga kjo kontratë, palët kontraktuese do t'i zgjidhin me marrë ato me dëshirën e mirë me mirëkuptim të ndërsjellët dhe, në rast të kundërt, Gjykata Administrative e Republikës së Shqipërisë do të jetë autoriteti kompetent.

### **Neni 10**

#### **Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e kontratës**

(1) Duke nënshkruar këtë kontratë, palët shprehin vullnetin e tyre të lirë, konfirmojnë se kanë lexuar dhe kuptuar kontratën dhe janë dakord me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë si dhe me pasojat e saj ligjore.

(2) Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese dhe mbetet në fuqi shtatë vjet pas ditës së *pagesës/pagesës përfundimtare* të bërë nga AZHBR.

### **Neni 11**

#### **Numri i kopjeve**

Kjo Kontratë përbëhet nga shtatë kopje identike origjinale, 6 mbeten brenda Agjencisë (AZHBR) për përdorim të brendshëm dhe një të mbetur prej tyre e mban Përfituesi i kësaj kontrate.

### **Neni 12**

#### **Shtojca**

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate:

Shtojca 1- Tabela e mallrave dhe shërbimeve E-3.0-1.14 'Fleta e aprovimit të përlogaritjes së investimeve'.

Shtojca 2- Tabela e specifikimeve nga oferta

Shtojca 3- Dukshmëria (përmasat dhe vula)

Shtojca 4- Raporti i Progresit për investimet e ndërtimit/rikonstruksionit

Shtojca 5- Grafiku i Punimeve

Shtojca 6- Kriteret e përzgjedhjes për investimin e propozuar

Datë, \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

Datë, \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

Nr. protokolli \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Drejtori i Përgjithshëm

Përfituesi:

Përfaqësues i Agjencisë (AZHBR)

---

Nënshkrimi

---

Nënshkrimi